

Lola Prendi

Ka përvojë pune duke filluar nga viti 1997 si në administratën publike, në qeverisjen vendore, qeverisjen qendrore dhe institucione të pavarura, në pozicione të tilla si: Përgjegjëse e zyrës Juridike, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie, Avokate Shteti, Këshilltare Ligjore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (KPK) si dhe aktualisht Këshilltare Ligjore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), si më poshtë:

Nga viti 2019 dhe aktualisht është në detyrën e këshilltares ligjore në Departamentin e shërbimeve ligjore të Njësisë së Mbështetjes së Komisioneve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).

Në vitin 2017 deri në 2019, ka mbajtur detyrën e këshilltares ligjore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (KPK).

Nga viti 2010 deri në vitin 2017 ka punuar në funksionin e Avokates së Shtetit pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit.

Nga viti 2008 deri në vitin 2010 ka mbajtur pozicionin e Drejtoreshës së Drejtorisë Juridike pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”(QSUT), Tiranë.

Nga viti 1997 deri në vitin 2007, ka mbajtur pozicionin e Drejtoreshës së Departamentit Juridik pranë Këshillit të Rrethit dhe Këshillit të Qarkut Shkodër.

Është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti “Luigj Gurakuqi, Shkodër dhe mban titullin "Juriste" nga viti 1996, Titullin “Avokate”, nga dhoma kombëtare e avokatisë, Tiranë, në vitin 2007 si dhe titullin “Avokat Shteti”, nga Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës në vitin 2010.

Është njohëse e gjuhës Angleze me Certifikatë në vitin 2001 si dhe njohëse shumë mirë e Gjuhës Italiane. Disponon disa certifikata nga trajnime në fusha të ndryshme legislative.